

Lënda: Mbi ankesën e znj. Bedrie Kaca

KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Tiranë

Për dijeni: Znj. Bedrie Kaca

Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr. 7510 prot., dt: 8.11.2022 drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ju sqarojmë se:

Referuar sistemit të pagesave të pensioneve (PCAMS) të ISSH-së, rezulton se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, e cila administrohet dosjen e përfitimit të znj. Bedrie Kaca, në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i ka caktuar znj. Kaca pension pleqërie, të cilin e përfiton nga data 04.10.2020 e në vazhdim.

Pasi kontaktua me DRSSH Tiranë, rezultoi se znj. Kaca nuk ka bërë kërkesë pranë kësaj Drejtorie për kopje të dosjes së pensionit, të njëzuar me origjinalin.

Në zbatim të Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, dosjet e pensioneve administrohen nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe në këtë rast kërkesa e znj. Caka, për kopje të njëzuar me origjinalin, të dokumentacionit të dosjes së pensionit, duhet t’i adresohet DRSSH Tiranë, nëpërmjet kërkesës zyrtare të nënshkruar prej saj, apo përfaqësuesit me prokurë, konform nenit 64, të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, (i përditësuar).

Faleminderit për mirëkuptimin.

